



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:077470

Datë: 26.04.2022

Numri i dokumentit: 02952488

**P.nr.101/2019**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN – dega Viti-** Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpuntoren profesionale Lumturije Fetahu në çështjen penale ndaj të pandehurit E.Anga fshati P.... K.Viti, për shkak të veprës penale: vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6, lidhur me paragrafin 4 dhe 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.258/2019, e datës 15.02.2019 pas përfundimit të shqyrtimit fillestar dhe publik të dt. 06.04.2022, ndërsa me datë 08.04.2022 mori, shpalli dhe me datë 26.04.2022 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari E.A, nga babai S...., nëna N..., e lindur Z...., i lindur me dt. 26.05.1968 në Gjilan, me vendbanim në fshatin P... K.Viti, i martuar, baba i 3 (tre) fëmijëve, ka të kryer shkollën e lartë, i vetëpunuar në biznes privat, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal 10124775534.

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse,

- me datën 17.10.2018, , në kohë të pa përcaktuar, në në fushën e sportit –stadiumin e tij, në fshatin Pozheran K. Viti, i pandehuri E.A, me qëllim që vetiti t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, pa leje dhe autorizim, ka bërë lidhjen e drejtpërdrejt në përçuesin e rrymës elektrike, pa orë matëse, në atë mënyrë që i njëjti ka furnizuar me energji elektrike pajisjet elektrike për nevoja të stadiumit, përmes të cilave është shpenzuar energjia elektrike në mënyrë të paautorizuar, me çka është pamundësuar regjistrimi i shpenzimeve të energjisë elektrike, në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS-it, Distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm material të përgjithshëm në shumë prej 1.541 € e 0.14 cent.

- me çka ka kryer veprën penale: vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6, lidhur me paragrafin 4 dhe 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 44, 7, 17, 38, 39, 43, 69, dhe 70 të KPRK-së, e nenin 326 lidhur me nenin 248 paragrafi 1 dhe nenin 365 të Kodit të Procedurës Penale, të akuzuarin e lartëcekur:

### **DENIM ME GJOBË**

Ashtu që të akuzuarit E.Apër veprën penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 300.00 (treqindë) €, të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj në afat në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

Nëse i akuzuari i lartcekur nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20 (njëzet) € të dënimit me gjobë.

Pala e dëmtuar KEDS, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të udhëzohet në kontest juridiko - civil.

Obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësore në shumën prej 20€ (njëzet) dhe 30 (tridhjetë) euro për viktimat e krimit konform nenit 39 par. 3 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me dt. 26.02.2019 ka dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjilan-dega Viti aktakuzën me numër PP.II.nr.258/2019 e datës 15.02.2019 kundër të akuzuarit E.Anga fshati Pozheran K.Viti, për shkak të veprës penale: lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 06.04.2022 , e cila seancë ishte publike, në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit Halim Borovci dhe i akuzuari E.A, në të cilën seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i cili edhe bëri rikualifikimin e veprës penale duke pasur parasysh se Kodi Penal në fuqi është më i favorshëm për të pandehurin sa i përket dënimit, e mbi këtë bazë vepra penale sipas dispozitivit të aktakuzës rikualifikohet në veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 4 dhe 1, të KPRK-se, dhe i akuzuari pas rikualifikimit të veprës penale deklaroi se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale të lartcekur.

### 2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata, pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë ndaj të akuzuarit të lartcekur për veprën penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose e shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranonte fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari E.Aka kryer veprën penale: vjedhja e shërbimeve nga neni 314 parag.6 lidhur me paragrafin 4 e 1 të KPRK-së, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 248 të KPP-së, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, të njëjtit i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 300.00 (treqindë) €, të cilin dënim obligohet ta paguaj, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale.

Gjykata, me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që për të akuzuarin, si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, se i njëjti është penduar dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, është mbajtës i familjes 10 (dhjetë) antarëshe, dhe është i vetmi që punon, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata e ka marrë për bazë faktin dëmin e shkaktuar të dëmtuarës dhe dashjen e të pandehurit në kryerjen e kësaj vepre penale.

5. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurës dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit duke i marr parasysh rrethanat lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. Gjykata, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38, të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprës penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenin 451 parag.1 të KPP-së ka vendosur që të akuzuarin ta obligojë ti paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 euro dhe 30 (tridhjetë) euro për viktimat e krimit konform nenit 39 par. 3 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Pala e dëmtuara KEDS, në kuptim të nenit 463 të KPP-ës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko - civil.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-dega Viti**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**P.nr.101/2019**  
**Me datë: 26.04.2022**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,**  
**Blerina Jakupi Ramadani**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.